

Këto ditë kur mediat serbe me të madhe po merren me këngën e *Gold AG*, *Pushka e Lirisë*, kushtuar Zahir Pajazitit, deputetja e kuvendit të Kosovës nga radhët e LDK-së ka shfrytëzuar rastin që edhe ajo t'i thotë disa fjalë për këngëtarin.

Lama, duke e ditur se *Gold AG* është edhe praktikues i fesë Islame, e ka ofenduar atë duke e quajtur analfabet e taleban.

Përmes një postimi në facebook ajo ka shkruar se është i mjerë ai popull që lejon lloj lloj analfabeti, profiteri e talebani t'i këndoje luftëtarëve të tij të lirisë, duke aluduar në këngëtarin *Gold AG* dhe këngën e tij, *Pushka e lirisë*, kushtuar Zahir Pajazitit.

Mediat serbe, këngëtarin *Gold AG*, e kishin akuzuar për nxitje të urrejtjes ndëretnike, pasi që videoklipi i këngës përmbante skena ku shiheshin duke u vrarë policë serbë nga ushtarët e UÇK-së./Shembulli/

